



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 15.10.2020)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për një shtesë në vendimin nr. 5, datë 20.12.2018, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Mbi caktimin me short të mandatit 3-vjeçar të anëtarëve gjyqarë dhe anëtarëve jogjyqarë”” (shtyrë nga mbledhja e datës 14.10.2020).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:30 dhe mbaroi në orën 11:55.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 6. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një shtesë në vendimin nr. 5, datë 20.12.2018, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Mbi caktimin me short të mandatit 3-vjeçar të anëtarëve gjyqtarë dhe anëtarëve jogjyqtarë”” (shtyrë nga mbledhja e datës 14.10.2020).

Naureda Llagami: Atëherë, përshëndetje të gjithëve.

Duke qenë se të gjithë anëtarët janë të pranishëm, po fillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 15 tetor 2020.

Siç jeni në dijeni, në rendin e ditës sot kemi dy çështje për të cilat kërkohet vendimmarrja e KLGJ-së.

Çështja e parë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për një shtesë në vendimin nr. 5, datë 20.12.2018, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Mbi caktimin me short të mandatit 3-vjeçar të anëtarëve gjyqtarë dhe anëtarëve jogjyqtarë””. Çështja e dytë është caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Atëherë, kalojmë nëse nuk kemi ndonjë diskutim për rendin.

Kalojmë në relatimin e çështjes së parë e cila do të bëhet nga zoti Muharremaj.

Erjon Muharremaj: Faleminderit, zonja Kryetare!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në pikën 5 të nenit 179 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 277, pika 7 të Ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, pasi u vu në dijeni të faktit se, në faqen zyrtare të internetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë është publikuar njoftimi për shpalljen e vendit vakant për anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor në datën 08.10.2020, e konsideron të arsyeshme të vlerësojë dhe saktësojë situatën juridike, si dhe të shprehet me vendim në lidhje me deklarimin e fillimit dhe mbarimit të mandatit të anëtarëve të Këshillit, duke bërë një shtesë të dy pikave, në vendimin nr. 5, datë 20.12.2018, pasi referuar nenit 147 të Kushtetutës, që është edhe neni që specifikon krijimin, qëllimin dhe funksionimin e KLGJ-së, sanksionohet ndër të tjera që Këshilli i Lartë Gjyqësor siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, si dhe më pas përcakton edhe përbërjen e Këshillit dhe konkretisht, në pikën 4 i referohet anëtarëve jogjyqtarë që zgjidhen nga radhët e avokatëve, dy anëtarë nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës, si dhe një anëtar nga shoqëria civile.

Ndërsa neni 147/b, i Kushtetutës referon mbarimin e mandatit të anëtarëve të KLGJ dhe në pikën 2 parashikohet që mbarimi i mandatit të anëtarit deklarohet me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Për të saktësuar: Sot Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk mblidhet për të deklaruar mbarimin e mandatit, por për të përcaktuar datën se kur këto mandate përfundojnë.

Këshilli si organ kompetent i cili deklaron fillimin dhe mbarimin e mandatit të anëtarëve nga radhët e juriste jomagjistratë si dhe të gjyqtarëve, duke patur në vëmendje faktin se KLGJ u krijua dhe u konstitua për herë të parë si një institucion i pavarur Kushtetues me vendimin nr. 4, në datë 12.12.2018, të KLGJ, nuk mund të konsiderojë mbarimin e mandatit për anëtarët e zgjedhur nga Kuvendi para kësaj date edhe në kushtet kur tashmë Kuvendi ka ndërmarrë një vendim të tillë duke shpallur thirrjen për aplikime për vendet vakante.

Referuar nenit 277 të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të Drejtësisë”, sa i përket krijimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në pikën 2 parashikohet se:

“... 2. Këshilli i Lartë Gjyqësor krijohet në ditën kur anëtari i fundit i tij zgjidhet nga autoritetet kompetente. Anëtari jomagjistrat më i vjetër në moshë, i zgjedhur nga

Kuvendi, përgatit dhe thërret mbledhjen e parë të Këshillit të Lartë Gjyqësor jo më vonë se 3 ditë pas datës së zgjedhjes së të gjithë anëtarëve...”, proces i cili është tejkaluar tashmë sepse të gjitha veprimet janë kryer në dhjetor të 2018-ës.

Bazuar në këto dispozita, konsiderohet inekzistent institucioni i KLGJ, deri në zgjedhjen e anëtarit të fundit të tij. Atë çka dashur të garantojë ligjvënësi duke i dhënë fund institucionit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, vetëm pasi të ishin përzgjedhur të gjithë anëtarët e KLGJ-së, ka qenë pikërisht vazhdueshmëria, funksionaliteti dhe garancia juridike institucionale për të mos lënë pushtetin gjyqësor pa organin e vetëm të vetëqeverisjes.

Në Vendimin nr.34/2017, të Gjykatës Kushtetuese, në pikën 26 parashikohet se “...Referuar ndryshimeve kushtetuese, gjykata konstaton se KLGJ-ja është një organ i ri Kushtetues, i përbërë nga 11 anëtarë, (6 gjyqtarë dhe 5 jogjyqtarë) që siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.”

Kushtetutëbërësi, në nenin 147, shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç” ka përcaktuar kompetencat, rastet e përgjegjësisë disiplinore, ato të mbarimit të mandatit të anëtarit të KLGJ-së, si dhe papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit. Në lidhje me krijimin e KLGJ-së, kushtetutëbërësi ka përcaktuar një periudhë kalimtare prej tetë muajsh nga hyrja në fuqi e ndryshimeve kushtetuese, duke përcaktuar në nenin 179, pika 5 të Kushtetutës se anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë e përfundojnë mandatin e tyre pas krijimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, por jo më vonë se zgjedhja e të gjithë anëtarëve të KLGJ-së. Nga ana tjetër, Kushtetuta në pikën 12 të po këtij neni parashikon qëndrimin e Presidentit të Republikës si kryetar i KLD-së deri në krijimin e KLGJ-së. Pra nuk mund të flitet për ekzistencë mandati ose mandat të ushtruar gjatë kohës së mosekzistencës së vet institucionit.

Gjithashtu pika 30 e vendimit 34/2017, parashikon që: “...Duke i vlerësuar rregullimet ligjore të neneve 160/1 e 173/1 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në kontekstin e detyrimeve që imponon parimi i shtetit të së drejtës për respektimin e hierarkisë së akteve normative, gjykata konstaton paraprakisht se neni 179 i Kushtetutës nuk përmban rregullim apo delegim të shprehur për ligjvënësin lidhur me përcaktimin e kompetencave që do të ushtrojë KLD-ja në periudhën kalimtare deri në krijimin e KLGJ-së. Megjithatë, gjykata vlerëson se ky

konstatim nuk mund të konsiderohet se përbën ometim kushtetues, pasi formulimi i pikës 5 të nenit 179 të Kushtetutës se “anëtarët e KLD-së e përfundojnë mandatin e tyre pas krijimit të KLGJ-së, por jo më vonë se zgjedhja e të gjithë anëtarëve të KLGJ-së, sipas ligjit”, shpreh dhe synon të sigurojë vlerën kushtetuese të vazhdimësisë dhe koherencës institucionale, për rrjedhojë, funksionimin normal të KLD-së në periudhën kalimtare. Për sa kohë vullneti i kushtëtutëbërësit ka qenë që të mos ndërpritet funksioni i KLD-së, gjykata vlerëson se KLD-ja ashtu si edhe organet e tjera ekzistuese kushtetuese do të vazhdojnë të ushtrorjnë funksionet e tyre deri në konstituimin e plotë të organeve të reja kushtetuese dhe, në këtë kuptim, zbatimi i neneve 160/1 dhe 173/1 të ligjit duhet të jetë në përputhje të plotë me këtë interpretim të Gjykatës, në respekt të frymës së Kushtetutës.” – këtu përfundoj citimin.

Dhe duke iu referuar interpretimit të bërë nga Gjykata Kushtetuese, nuk mund të pretendohet se emërimi i anëtarëve jogjyqtar zgjedhur nga Kuvendi kanë patur një mandat nga data e përzgjedhjes së tyre, që është konkretisht 08.02.2018, pasi institucioni i KLD ka qenë në funksion dhe ka ushtruar kompetencat e tij deri në zgjedhjen e anëtarit të fundit të KLGJ-së, ku me zgjedhjen e anëtarit të fundit ka patur dhe detyrimin Kushtetues që jo më vonë se 3 ditë pas datës së zgjedhjes së të gjithë anëtarëve, të thërrasë mbledhjen e parë plenare.

Nëse do bëhej një analogji e organit të KLGJ-së me një organ tjetër, që ka një përbërje të përafërt për shkak të përzgjedhjes së anëtarëve dhe mënyrës së krijimit, mund të bëhet deri diku me Gjykatën Kushtetuese, ku duke iu referuar Vendimit nr. 24/2011 të Gjykatës Kushtetuese në pikën 31 “...Me qëllim që të përcaktohet nëse një organ është “i pavarur”, Gjykata çmon se, ndër të tjera, duhet konsideruar mënyra e emërimit të anëtarëve të tij, si dhe kohëzgjatja e funksionit të tyre. Garancia e kohëzgjatjes dhe paprekshmërisë së mandatit e mbron gjyqtarin nga ndikimet e forcave politike që mund të vijnë në pushtet. Vetëm një gjykatë e pavarur, të cilës i garantohet paprekshmëria e mandatit të anëtarëve të saj, mund të konsiderohet si një gjykatë që administron drejtësinë kushtetuese, në përputhje me parimet kushtetuese. Edhe pse mandati i gjyqtarit kushtetues ka kuptimin e një mandati të dhënë (jo të fituar nëpërmjet votës së zgjedhësve aktivë), parimi i pavarësisë nënkupton, gjithashtu, se gjyqtari, në momentin e emërimit, duhet të dijë kohëzgjatjen e këtij mandati, bazuar në rregullimet ligjore përkatëse dhe kjo

kohëzgjatje nuk mund të lihet në diskrecion të organeve që e kanë emëruar apo zgjedhur atë” – këtu e mbyll referimin.

Gjithashtu duke iu referuar pikës 37, të po të njëjtit vendim “...Gjykata rithekson se në zbatim të parimit bazë të shtetit të së drejtës, atij të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve, kushtetutëbërësi ka përcaktuar, për secilin nga organet që përfaqësojnë këto pushtete, kompetencat që përputhen/i përgjigjen qëllimit të tij. Për sa kohë këto kompetenca janë të përcaktuara nga normat kushtetuese, është e palejueshme që një organ tjetër t'i marrë ose t'i anashkalojë ato me vullnetin e tij.

Kështu që, të ndodhur përpara faktit që Kuvendi ka shpallur publikimin e aplikimit për thirrje të paraqitjes së shprehjes së interesit të 2 mandateve për pedagogë anëtarë të Këshillit, bazuar në nenit 37 të ligjit “Për organet e qeverisjes...”, ku saktësohet se: “1. Jo më vonë se 4 muaj para datës së mbarimit të mandatit të anëtarëve pedagogë të Këshillit të Lartë Gjyqësor në detyrë, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit shpall vendet vakante në faqen zyrtare të Kuvendit dhe në çdo mënyrë tjetër të përshtatshme. ...”, lind nevoja tashmë që Këshilli të shprehet me vendim në lidhje me deklarin e fillimit dhe mbarimit të mandatit të anëtarëve të Këshillit, për të bërë të mundur pezullimin e procedurës së iniciuar në mënyrë jo të saktë nga Kuvendi, duke interpretuar edhe bazën ligjore që u përmend gjatë këtij relacioni.

Në përmbajtje të vendimit që propozohet të miratohet sot, në pikën 1 parashikohet që në vendimin nr. 5, datë 20.12.2018, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Mbi caktimin me short të mandatit 3-vjeçar të anëtarëve gjyqtarë dhe anëtarëve jogjyqtarë” pas pikës II të vendimit, shtohen pikat III dhe IV me përmbajtjet respektive.

Në pikën e 2-të - Mandati i anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor që shërbejnë me mandat trevjeçar ka filluar në datën 12.12.2018 dhe përfundon në datën 12.12.2021.

Dhe në pikën 3 të vendimit parashikohet - Mandati i anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor që shërbejnë me mandat pesëvjeçar ka filluar në datën 12.12.2018 dhe përfundon në datën 12.12.2023.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe versioni i konsoliduar i vendimit publikohet në faqen e internetit të Këshillit. Ju faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, Erjon!

Ndonjë diskutim nga kolegët?

Medi Bici: Po zonja Kryetare, meqenëse po e marr fjalën unë.

Unë nuk kam asgjë me Erjonin dhe me Maksin. Ata kanë filluar punën në KLGJ më datë 12.12.2018. Po të kisha gjë në dorë do t'i jepja edhe një mandat tjetër 5-vjeçar. Me Erjonin kam një ngjashmëri, përveç se e kam pasur edhe koleg zyre, tek korrektesa. Por për mendimin tim ky akt që ka ardhur sot për miratim nuk është produkt i Këshillit, pasi unë dje erdha në dijëni dhe besoj edhe unë jam pjesë e Këshillit. Sipas ligjit, mandati i anëtarëve të Këshillit deklarohet i përfunduar me vendim të Këshillit, ditën që ai mbaron. Pra është ky organ që vë në dijëni organet e emërtesave disa muaj përpara përfundimit të mandateve dhe jo këto të fundit të fillojnë procedurat kryesisht.

Për mua nuk ka nevojë për ndryshimin e vendimit, por edhe një shkresë zyrtare mund ta kryente këtë punë.

Nuk kam asnjë lloj propozimi dhe mbështes qëndrimin e relatorit.

Kam menduar se me kalimin në godinën e re do të ndryshojë edhe mendësia e drejtuesve tanë, për të mos e ndarë Këshillin në tre-katër parcela dhe të tjerët të mbeten jashtë liste, por Këshilli të funksionojë si një organ kolegial.

Mendimi im është që Kuvendi ka nisur procedurat për të emëruar kryetarin e ri të KLP-së për një mandat 5-vjeçar, pasi në Prokurori mund të mbyllen çështjet për ujçërit e korrupsionit, të veshur me pushtet.

Duke i ndërruar juristët e shquar të dy këtyre Këshillave me një kryetar të emëruar.

Unë e kam ngritur zërin disa herë, se ne gjyqtarët, që jemi shumica në Këshilla (si tek Prokuroria edhe këtu), jemi cilësuar korporatë dhe na lanë pa asnjë lloj përfaqësimi në organet drejtuese të Këshillit. Por tani, edhe ju të nderuar juristë, pa bërë ende 2 vjet, politika kërkon t'ju bëjë kurban për një kryetar të emëruar.

Prandaj kërkoj nga kryesia e Këshillit, sidomos nga Maksi, që të përfundojmë sa më shpejt atë rregullore të brendshme në mënyrë që kur të përfundojë mandati, ta kemi të qartë se çfarë të drejtash dhe detyrash kemi patur sepse gjatë 2 vjetëve nuk e dimë se çfarë detyrash kemi. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Bici!

Ndonjë koleg tjetër e do fjalën?

Alban Toro: Mund të ndërhyj edhe unë diçka?

Ashtu siç tha edhe kolegu parafolës, ky është një vendim i sforcuar i Këshillit dhe po i përgjigjemi një sjelljeje që po bëhet si modë nga ana e Parlamentit, për të ushtruar kompetencat edhe aty ku nuk ka. Kam folur vazhdimisht që duhet të reagojmë ndaj kësaj lloji qasjeje sepse kemi parë edhe në forma të tjera, si ndaj buxhetit apo aspekte të tjera që kanë lidhje me Këshillin. Ndërkohë që neni 7 i Kushtetutës apo Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ka shprehur më shumë se një herë se parimi i shtetit të së drejtës i detyron të gjithë organet e pushtetit publik t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër të normave kushtetuese dhe mjafton t'ju them apo të sjell si referencë vendimin 1 të Gjykatës Kushtetuese të 2011-ës dhe pas këtij vendimi, ka pas edhe akte të tjera të Gjykatës Kushtetuese që e kanë përforcuar dhe e kanë shtjelluar me detaje se çfarë do të thotë parim i shtetit të së drejtës apo ndarja e pushteteve dhe respektimi i kompetencës së secilit institucion kushtetues. Kështu që në këtë aspekt, do të sugjeroja që përpos kësaj vendimmarrjeje të sforcuar që ne po marrim, të dalim edhe me një deklaratë që ndoshta mund të sensibilizojë veshët e mbyllur të Parlamentit, që të mos kryejnë e të mos marrin nisma të tjera sepse të jeni të sigurt që në të ardhmen vlerësoj që do të verifikohen përsëri sjellje të tilla apo qasje ndaj Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kështu që, ndoshta do të ishte me vend edhe një deklaratë në media, në 'website', zgjidhni kë të doni, në mënyrë që kësaj lloji qasjeje t'i jepet fund. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, kolegëve.

Ndonjë diskutim tjetër?

Nëse jo, me sa kuptova nuk kemi një propozim konkret për projekt-aktin.

Kalojmë në votimin e projekt-aktit?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Kundër, me arsyetimin që vendim nuk ka shkak ligjor, bazë ligjore. Më duket sikur ne gjejmë një mënyrë joligjore për të reaguar ndaj aktit procedural që është kryer nga ana e Kuvendit. Në këtë formë të pabazuar në ligj, më duket sikur ne sot u mblodhëm dhe vlerësuar që dimë matematikë, që 2018 plus 3, bëjnë 2021 dhe 2018 plus 5, bëjnë 2023 dhe nuk më duket fare me vend si vendim. Ka mënyra të tjera

për të reaguuar ndaj asaj që duket nga ai relacioni se përbën shkak për këtë vendimmarrje. Po ata që e iniciuan këtë proces, mund të inicionin edhe një reagim më dinjitoz, që ka kuptim dhe që është në përputhje me ligjin, për t'iu drejtuar Kuvendit të Shqipërisë.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord dhe mbështes edhe propozimin Albanit, që të dalim edhe me një deklaratë për t'i treguar Kuvendit që jemi një organ i pavarur dhe s'mundet të shkelen dispozitat kushtetuese për kompetencat që ka Këshilli i Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Marçela Shehu: Dakord. Megjithëse ndaj pak a shumë një qëndrim të ngjashëm me disa nga kolegët sepse për ne çështja e mandatit dhe kohëzgjatja e tij nuk ka qenë ndonjëherë diskutim. As nga ana logjike, as nga ana ligjore dhe kushtetuese, nuk besoj se kishte vend për t'u diskutuar. Gjithsesi, për të shmangur çdo lloj paqartësie apo të kuptuar jo të qartë nga ana e Kuvendit apo ndonjë institucioni tjetër, unë bie dakord që kjo çështje të qartësohet dhe ne të disponojmë me vendim.

Gjithashtu unë do doja si kolegët, me anë të një shkrese, të vendosnim një urë komunikimi, një komunikim zyrtar institucional, jo vetëm me Kuvendin por edhe me institucione të tjera, me të cilat ne kemi marrëdhënie të tilla institucionale, për shkak të ligjit dhe Kushtetutës, me qëllim që procedura të tjera dhe eksperiencia të tilla të mos ndodhin më në të ardhmen. Jam dakord. Faleminderit!

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e vendimit "Për një shtesë në vendimin nr. 5, datë 20.12.2018, të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Mbi caktimin me short të mandatit 3-vjeçar të anëtarëve gjyqtarë dhe anëtarëve jogjyqtarë" - Në vendimin nr. 5, datë 20.12.2018, të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Mbi caktimin me short të mandatit 3-vjeçar të anëtarëve gjyqtarë dhe anëtarëve jogjyqtarë" pas pikës II të vendimit, shtohen pikat III dhe IV, si më poshtë:

“III. Mandati i anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor që shërbejnë me mandat trevjeçar ka filluar në datën 12.12.2018 dhe përfundon në datën 12.12.2021”.

“IV. Mandati i anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor që shërbejnë me mandat pesëvjeçar ka filluar në datën 12.12.2018 dhe përfundon në datën 12.12.2023.”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe versioni i konsoliduar i vendimit publikohet në faqen e internetit të Këshillit.

* * *

(Pika e 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 15.10.2020)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.¹

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:30 dhe mbaroi në orën 11:55.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|---------------------------------|
| 1. Naureda Llagami | <i>(kryetare)</i> |
| 2. Maksim Qoku | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 3. Medi Bici | <i>(anëtar)</i> |
| 4. Fatmira Luli | <i>(anëtare)</i> |
| 5. Brunilda Kadi | <i>(anëtare)</i> |
| 6. Dritan Hallunaj | <i>(anëtar)</i> |
| 7. Ilir Toska | <i>(anëtar)</i> |
| 8. Alban Toro | <i>(anëtar)</i> |
| 9. Brikena Ukperaj | <i>(anëtar)</i> |
| 10. Marçela Shehu | <i>(anëtare)</i> |

¹ Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 6. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
- 7. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

RENDI I DITËS:

2. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Kalohet në çështje e dytë të rendit të ditës: Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Zoti Toska parashtron se janë përgatitur dy relacione. I pari lidhet me nevojat e **Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat**, e cila ka paraqitur nevojën për caktimin e dy gjyqtarëve në një çështje në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 2.

Propozimet vijuese janë:

Në shortimin e kësaj çështje të përjashtohet kryetarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, konkretisht: znj. Esmeralda Xhili (Çeka), e cila është edhe anëtare e Kolegjit Zgjedhor si dhe është caktuar për disa çështje pranë Gjykatës së Posaçme. Propozohet edhe përjashtimi i magjistrates Lorena Çabej e cila ditën e djeshme u komandua nga Këshilli si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë. Po kështu është në proces edhe trajtimi i komandimit të magjistrates Zeta Terpollari (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje), e cila ka kërkuar të komandohet pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtaret Saemira Hila dhe Ersida Bajgora.

Relacioni i dytë lidhet me nevojat që paraqet **Gjykata e Apelit Shkodër**, e cila ka paraqitur nevojën për caktim të një gjyqtari në një çështje me lëndë penale.

Fillimisht bëhet e ditur nga zoti Toska se fillimisht ishin kërkuar 2 gjyqtarë, por pas vendimit të Këshillit për komandimin e zotit Çela dhe caktimin e tij në Gjykatën e Apelit Shkodër, Gjykata e Apelit Shkodër ka rikonsideruar kërkesën për caktim gjyqtari, duke kërkuar caktimin në këtë çështje të vetëm 1 gjyqtari.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit Durrës dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Anita Mici.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor